

VENDIM
Nr.438, datë 11.4.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË PESË KONVOJEVE USHTARAKE ITALIANE
DHE TË NJË AUTOMJETI USHTARAK SLOVEN, PËRMES TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes së kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 12 (dymbëdhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 12 prill 2008.

2. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 15 prill 2008.

3. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 17 prill 2008.

4. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 26 (njëzet e gjashtë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 17 prill 2008.

5. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 12 (dymbëdhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 18 prill 2008.

6. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) automjeti ushtarak sloven, me personel, 2 (dy) trupa ushtarake slovene, i ngarkuar me armë, mjete dhe pajisje ushtarake, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datat 23-25 prill 2008.

7. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

8. Konvojet italiane dhe automjeti ushtarak sloven, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha